




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.496/2022
Datë: 27 dhjetor 2022


KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të shpall njoftim për ekspertët gjyqësor të licencuar, qoftë në mënyrë individuale apo përmes listës së institucioneve publike dhe të specializuara, që të njëjtit të paraqiten në objektin e KGJK-së për të kryer pagesën prej 250€, nga 16 janar 2023 deri 16 shkurt 2023, në mënyrë që të njëjtit të pajisen me certifikatë dhe të regjistrohen në regjistër siç përcaktohet me Rregulloren Nr. 03/2022.
- II. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së të ndërmerr të gjitha veprimet lidhur me publikimin e regjistrit të ekspertëve gjyqësor të emëruar me informatat identifikuese, pas deponimit të nënshkrimit dhe kopjes së vulës së tyre në Këshill, në ueb faqen zyrtare të KGJK-së dhe të njëjtën t'ia përcjell edhe Gjykatave
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës